

16 Mars, 2023

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Gjatë viteve të fundit, shumë prej jush kanë përfituar nga programi “PHLConnect ED” i Qytetit të Filadelfias dhe kanë fituar akses në shërbimin falas dhe të sigurtë të internetit. **Këtë verë për “PHLConnect ED” – dita e fundit e shërbimit të sponsorizuar të internetit përmes “PHLConnect ED” është 31 Korrik 2023.**

Ndërsa shërbimi i “PHLConnect ED” po kalon, ne po punojmë me qytetin për të rritur ndërgjegjësimin rreth “Affordable Connectivity Program (ACP)” / Programit të Lidhshmërisë së Përbalueshme (ACP). ACP është programi i subvencionit të internetit të qeverisë federale që u siguron familjeve të kualifikuara deri në 30 dollarë nga fatura e tyre ekzistuese mujore të internetit. **Të gjitha familjet që janë shtëpi e një studenti që ndjek një shkollë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias kanë të drejtë për përfitime ACP. Ne inkurajojmë të gjitha familjet e drejtorisë që kanë nevojë për akses në internet të sigurtë të aplikojnë për ACP, pavarësisht nëse jeni aktualisht i regjistruar në “PHLConnect ED” apo jo.**

Hapat e Ardhshme për t'u Regjistruar në ACP

Për pjesën tjetër të vitit shkollor, “PHLConnect ED” do të mbështesë familjet nga klasat PreK deri te klasat e 12-të me nevoja të reja për akses në internet dhe të aplikojnë për ACP. **Familjet duhet të aplikojnë për ACP përpara datës 31 Korrik 2023 për të vazhduar marrjen e internetit falas ose me kosto të ulët.** Për të filluar aplikimin tuaj, plotësoni fushat e theksuara në [këtë letër verifikimi](#). Më pas vizitoni getacp.org/phl për të filluar aplikimin tuaj. Pasi aplikimi juaj të dorëzohet dhe miratohet, mund të kontaktoni ofruesin tuaj të shërbimit të internetit dhe të shtoni ACP në planin tuaj ekzistues ose të kërkonti një plan të ri që, kur kombinohet me përfitimin ACP, bëhet falas.

Përsëri, për të mësuar më shumë rreth ACP dhe për të filluar aplikimin tuaj, vizitoni getacp.org/phl. Për të marrë ndihmë [kontaktoni një PHLConnect ED Digital Navigator online](#) ose telefononi 2-1-1 për të caktuar një takim. Shtypni 8 për shërbimet gjuhësore. Nëse është e nevojshme, mund të plotësoni dhe dërgoni gjithashtu një [aplikim në leter](#).

Qasja në internet të sigurtë është thelbësore për t'u siguruar që fëmijët tanë të marrin një arsim të plotë. Drejtorja dhe Qyteti janë të përkushtuar t'ju ndihmojnë të merrni mbështetjen dhe shërbimin që ju nevojitet.

Sinqerisht,

Drejtorja Arsimore e Filadelfias